



Pranuar / Dorëzuar Priljeno / Prodato Received / Delivered	12.08	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Orgj / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM48HCK	4696/2022		119	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.579/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.579/2022 të datës 29.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

me adresë lagje

kundër Vendimit me Nr.27/2022 të datës 14.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.579/2022 e datës 29.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.27/2022 i datës 14.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

A r s y e t i m

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, më datë 21.04.2022 ka njoftuar që nga data 12.05.2022 deri më datë 25.05.2022 do të lejohet aplikimi në konkursin me Nr. referencë: RN00008856 për grupin e pozitive "Specialist Ligjor" gjegjësisht "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale në Ferizaj. Në këtë konkursi ka aplikuar edhe ankuesi, i cili në bazë të Vendimit me Nr. 18/2022 të datës 09.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore i është refuzuar aplikacioni për shkak të mos plotësimit të kushtit të përvojës së punës.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 11.06.2022 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, më datë 14.06.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 27/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi, me datë 29.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3786/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.27/2022 të datës 14.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.07.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas. Ndërsa Këshilli më datë 12.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesa e datës 29.06.2022 nr. Protokoll 3786/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër rendor Anr.579/2022; Certifikatë e datës 02.06.2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj mbi praktiken gjyqësorë; Vendim me Nr. 27/2022 me protokoll. 278-03/1 i datës 14.06.2022 për verifikimin paraprak; Ankesë nr. 271-03/1 e datës 13.06.2022; Vendim nr. Protokoll 255-0311 i datës 09.06.2022; Kontratë e punës nr.3/324 e datës 09.10.2018; Vërtetim i datës 06.07.2018; Certifikatë e datës 31.12.2018; Letër reference e lëshuar nga zyra e Avokatit për ankuesin; Vërtetim i datës 16.11.2021; Kontratë e punës praktike me pagës e datës 15.11.2019; Përgjigje në ankesë e datës 12.07.2022, kërkesë për urgjence e datës 15.07.2022; Vendim nr. 147-02 i datës 21.04.2022; Konkursi i datë 21.04.2022; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe të refuzuar nga SIMBNJ; Njoftimi nr. 262-03/1 i datës 09.06.2022; Njoftim nr. 280-03/1 i datës 14.06.2022; Vendim i datës 01.02.2022; Vendim nr. 395-02 i datës 07.12.2021; Aplikacion i datës 16.05.2022; Kopje e ID; Diplomë e datë 30.08.2015; Diplomë e datë 01.10.2019; Certifikatë lëshuar nga GIZ; Certifikatë e datës 01.05.2018; certifikatë e datës 01.11.2021; Certifikatë e datës 01-31.12.2018; Vërtetim i datës 02.11.2021 lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina"; Vërtetim lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj i datës 02.06.2021; Certifikatë e datë 1.05.2022 lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, nga evidenca personale; Ankese e datës 13.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar,  
*sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.27/2022 të datës 14.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, me pretendime ankimore se i plotëson kriteret e konkursit të shpallur me numër Nr. referencë: RN00008856 dhe dokumentacionin e kërkuar i ka dërguar në formë elektronike sipas kriterëve të kërkuara në konkurs, dhe ai pretendon se refuzimi i aplikacionit është bërë për shkak të vërtetimit të gabuar të përvojës së punës duke propozuar që të anulohet verifikimi paraprak dhe që ti jepet mundësia që të vazhdoj në procedurë mëtejme të rekrutimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se konkursi ka qenë i shpallur nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas për grupin e pozitave "Specialist Ligjor" gjegjësisht "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale në Ferizaj, kërkesat e përgjithshme për pranim kanë qenë: "Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar. Të zotërojë njërën nga gjuhët

zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryere detyrën përkatëse. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”, ndërsa kushtet formale janë kërkuar: “Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, Fakulteti Juridike me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to...Përvoja e punës së kërkuar: se paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë”. Po ashtu në konkurs është përcaktuar dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim: “Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, Kopjet e dëshmisë së punësimit, Kopjet e dëshmisë së trajnimeve, Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende, Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar, nga gjykata kompetente”.

Bazuar në provat e administruara të lëndës, të dërguar nga ankuesi dhe institucioni, Kolegji konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit përmes sistemit elektronik ka dorëzuar aplikacionin dhe dokumentacionin e bashkangjitur, ku i njëjti posedon Diplomën me Nr. 6538 të lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” më të cilën dëshmohet që ka përfunduar studimet themelore më datë 02.07.2019 duke marr titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, i njëjti posedon Certifikatën e datës 02.06.2021 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj ku dëshmohet se ka kryer praktikën gjyqësore në këtë gjykatë prej datës 03.06.2020 deri më datë 02.06.2021, posedon Vërtetim të datës 16.11.2021 me të cilën dëshmohet se ka kryere praktiken profesionale prej datës 01.07.2019 deri më datë 29.12.2019 në zyrën e avokatit në bazë të letër reference i njëjti nga data 01.04.2021 deri më datë 30.09.2021 ka kryere praktiken në zyrën e Avokatit më tutje i njëjti sipas Certifikatës së datës 31.12.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ka qenë i angazhuar si praktikant nga data 01.10.2018 deri më datë 31.12.2018, si rrjedhojë e kësaj Kolegji, konstaton se ankuesi të gjithë këtë përvojë e ka në cilësinë e praktikantit.

Sa i përket punës praktike, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i'u referuar Ligjit Nr.03/L-212 të Punës konkretisht nenit 16 paragrafit 4 është e përcaktuar se: “4. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj”, andaj mbi këtë bazë ankuesit i njihet vetëm një vite i punës praktike me përgatitje pasuniversitare rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, bazuar në kompetencat e përcaktuara dhe me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 dhe paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve, ku sipas Vendimit me Nr. 18/2022 të datës 09.06.2022 ka refuzuar aplikimin e ankuesit për shkak të mos plotësimit të kushteve lidhur me përvojën e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 18/2022 të datës 09.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, ka konstatuar që ky vendim është nxjerr në pajtim me kriteret e përcaktuar në konkurs që të njëjtat janë derivat i kërkesave të përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe shtojcën Nr. 1/9 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe si

rrjedhohë ky vendim është në pajtim me nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.... 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve...".

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.27/2022 të datës 14.06.2022 mbi refuzimin e ankesës së ankuesit të datës 11.06.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me refuzimin e aplikacionit të ankuesit për pozitën: "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale në Ferizaj.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.579/2022

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtores së Përgjithshëm të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
- Udhëheqësit të Njësies së Burimeve Njerëzore në Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.